



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1215/14 prot.

Datë 08.07.2025

**V E N D I M**  
**Nr. 869 /2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.07.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.809/2025, datë 24.06.2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e Lartë Monetar” Marrëveshje kuadër me objekt me disa operatorë ekonomikë, me objekt: Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 (tre) Lote, **Loti 1** me Nr. REF-38670-02-19-2025, me objekt: “Blerje materiale Kancelarie me bazë letre”, me fond limit 29,805,128 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” shpk, me Nipt L91418502J, Adresa: Z.Kadastrale nr.8517, Ndërtese 4 kate, me sip. trualli 1000 m<sup>2</sup>, Durrës.

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk, me Nipt J62426002Q, Adresa: Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.  
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë.

**Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “INPRESS” shpk, me Nipt L52122014L  
Adresa: Rr: “Siri Kodra”, ish blloku i magazinave, Tiranë.

Operatori ekonomik "LIBRARI DYRRAHU" shpk, me Nipt L91418502J, Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës km. i fundit, zona kadastrale nr.8517, ndërtesa 4 kate, Durrës.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik". Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 24.06.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.809/2025, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "Librari Dyrrahu" Shpk për procedurën e prokurimit sipërcituar në procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur mbi kufirin e Lartë Monetar" Marrëveshje kuadër me objekt Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 (tre) Lote, Loti 1 me Nr. REF-38670-02-19-2025, me objekt: "Blerje materiale Kancelarie me bazë letre", me fond limit 29,805,128 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik "InfoSoft Office" Shpk, në lidhje me pretendimet e ngritura për skualifikim të operatorit ekonomik "INPRESS" Shpk për procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik "InfoSoft Office" Shpk, në lidhje me pretendimet e ngritura për operatorin ekonomik "LIBRARI DYRRAHU" Shpk për procedurën e prokurimit sipërcituar.
4. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të ofertave mbi arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë "INPRESS" Shpk dhe "LIBRARI DYRRAHU" Shpk, në zbatim të vendimit të KSHA-së dhe konstatimeve të këtij vendimi.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë Komisionin mbi zbatimin e Vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Librari Dyrrahu" Shpk.

7. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” Shpk.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën ardhur me Nr.632/37 datë 03.07.2025 protokolluar me tonën me nr. 1215/11, datë 04.07.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar Vendimin e KPP-së me Nr. 809/2025 datë 24.06.2025 për procedurën e prokurimit objekt gjykimi.

## II

### Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### Arsyeton:

II.1. Nr.632/37 datë 03.07.2025 protokolluar me tonën me nr. 1215/11, datë 04.07.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar Vendimin e KPP-së me Nr. 809/2025 datë 24.06.2025 për procedurën e prokurimit objekt gjykimi

II.2. Referuar shkresës sipërcituar nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor më datë 03.07.2025 ka kryer rivlerësim të ofertave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në zbatim të vendimit të KSHA-së dhe konstatimeve të vendimit të KPP-së.

II.3. Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A. ka zbatuar vendimin Nr. 809/2025 datë 24.06.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e Lartë Monetar” Marrëveshje kuadër me objekt me disa operatorë ekonomikë, me objekt: Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 (tre) Lote,

**Loti 1** me Nr. REF-38670-02-19-2025, me objekt: “Blerje materiale Kancelarie me bazë letre”, me fond limit 29,805,128 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e mbi kufirin e Lartë Monetar” Marrëveshje kuadër me objekt me disa operatorë ekonomikë, me objekt: Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 (tre) Lote, **Loti 1** me Nr. REF-38670-02-19-2025, me objekt: “Blerje materiale Kancelarie me bazë letre”, me fond limit 29,805,128 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.04.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

